



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267717
Datë: 22.11.2021
Numri i dokumentit: 02425243

A.nr.1026/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditëses Kompania Regjionale e Ujësjiellit Gjako SH.A. me seli në Gjakovë kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, në seancën publike të mbajtur me datë 09.11.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditëses Kompania Regjionale e Ujësjiellit Gjako SH.A. me seli në Gjakovë, si e pabazuar.

Mbetet në fuqi Vendimi nr.80/2019 datës 29.03.2019 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (në tekstin e mëtejme ATK), në procedurën administrative të ankesave, ka refuzuar ankesën e paditëses, dhe ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll.

Paditësja Kompania Regjionale e Ujësjiellit Gjako SH.A. me seli në Gjakovë, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 30.04.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e padisë, të priset dhe ndryshohet vendimi i të paditurës nr.80/2019 i datës 29.03.2019, ashtu që të aprovohet në tërsi si e bazuar padia e paditëses, të shfuqizohen Njoftimet e të paditurës për rivlerësim të tatimit në fitim dhe caktimin e tatimit në fitim për vitin 2012-2018 në shumë të përgjithshme prej 158.632.98€, si dhe vendimin për shqiptimin e gjobave në shumë prej 4,000.00€ të lëshuara nga Zgjona e ATK-së.

Në padinë e saj dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën publike, paditësi deklaron: në Raportin e kontrollës të paditurës të datës 11.02.2019 paditëses i janë zvogëluar në mënyrë drastike shpenzimet e zhvlerësimet, paditësi me kontroll financiar është detyruar të paguaj tatim në fitim në shumë të përgjithshme prej 158,632.98€, dhe i janë shqiptuar gjoba në shumë të përgjithshme prej

4,000.00€, sipas vendimit për shqiptimin e gjobave të lëshuar nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime, me arsyetim se shpenzimet e zhvlerësimit nuk janë dokumentuar me fatura, dhe se në regjistrimin në mbajtjen e tatimeve ligjore ka pasur parregullsi. Në provat, dokumentacionin që i është bashkangjitur kësaj padie, vërtetohet se paditësja nuk ka bërë shkeljet tatimore të kualifikuara nga ana e të paditurës me vendimin e atakuar kësaj padi, pasi që paditësi ka vepruar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe me rekomandimet e të paditurës rreth evidentimit, regjistrimit paraqitjes dhe pagesës së tatimeve respektivisht lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit si shpenzime të zbritshme konform vendimit shpjegues të lartpërmendur, andaj nuk ka bazë ligjore detyrimi i caktuar me vendimin e atakuar në këtë padi për të paguar tatim shtesë në shumë të përgjithshme prej 158,632.98€, sipas njoftimeve kontestuese për rivlerësim të tatimeve për vitin 2012-2018 të cilat janë lëshuar bazuar në Raportin kontestues të kontrollit të datës 11.02.2019 e as detyrimi për të paguar gjoba administrative në shumë të përgjithshme prej 4,000.00€, sipas vendimit për shqiptimin e gjobave nr.prot 0179/2019 i datës 12.02.2019 i lëshuar nga zyra e të paditurës për gjoba dhe ndëshkime administrative. Mbajtja në fuqi e vendimit të atakuar, paditëses do të shkaktoj dëme të konsiderueshëm material dhe jo material, bazuar në faktin se paditësja ofron shërbime jetike-shërbimin e ujit të pijes për qytetarët e Komunës së Gjakovës, Rahovecit, etj, dhe mos pranimi i shpenzimeve nga ana e të paditurës do të rëndon mbijetesën dhe funksionimin e paditëses, si biznes që ushtron veprimtari ekonomike me interes publik, kështu që për këtë arsye paditësi pret se gjykata do të korrigjojë këtë padrejtësi që i është bërë paditëses nga ana e të paditurës, si pasoj e nxjerrjes së vendimit të atakuar me këtë padi, andaj përmes kësaj padie, paditësi i propozon gjykatës që me rastin e vendosjes sipas kësaj padie, të merr në konsideratë argumentet ligjore dhe faktet të precizuara në këtë padi dhe të aprovoj si të bazuar në tërësi këtë padi. Përfaqësuesi i autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor deklaron: në mungesë të kostos historike nga AKM-ja aksionare në atë kohë pas luftës në vitin 2007 i ka vlerësuar të gjithë Ujësjetellësit e Kosovës, dhe është rritur vlera e aseteve, ne që e dimë shpenzimet e zhvlerësimit llogariten në kosto, por në mungesë të kostos historike zhvlerësimin e kemi llogaritur në vlerën e vlerësuar, nga licensuesit e pavarur ["G..."], po jemi bazuar në vendimin shpjegues publik nr.05/2009, neni 4 pika 2.2. në vitin 2012 kemi pas kontrollën e parë nga ATK-ja, për vitet 2004 dhe 2010, për kontrollën që e kemi bërë për inspektorët e pranojnë shpenzimet e zhvlerësimit në vlerësimin e aseteve, posedojmë Raportin e kontrollës si dëshmi, në vitin 2019 pason kontrolla e radhës nga inspektorët e ATK-së dhe nuk e pranojnë shpenzimin si të zbritshëm për vitin 2012/2015, kthehen pas dhe aplikojnë tatim shtesë, gjoba duke mos pranuar shpenzimet e zhvlerësimit. I propozojmë gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke e obliguar të paditurën që ti kthej paditëses mjetet e inkasuara në mënyrë të padrejtë, me kamatë ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi dt.15.03.2021 deklaron: Vlerësimi tatimor është kryer bazuar në legjislacionin tatimor të aplikueshëm, dhe dokumentacionin e tatimpaguesit të siguruar nga ana e ATK-së dhe informatave tjera. Kontrolli është bazuar në librat dhe regjistrimet e tij ku janë përfshirë, librat dhe faturat e blerjes, transaksionet bankare, kuponët dhe faturat e shitjes të evidentuar tek paditësi, librat e blerjeve dhe shitjeve, deklaratat tatimore, etj. Kontrolli bazuar në provat e lartëcekura ka rezultuar me ndryshime në të hyra dhe shpenzime dhe ndëshkime konform legjislacionit tatimor. Administrata Tatimore e Kosovës si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, për qëllime të përgjigjes në padi në vazhdim i kundërshton pretendimet e paraqitura në padi të paditësit, si të pabazuar në ligj dhe në faktë materiale, dhe vlerëson se vendimi i apeluar i D.A. të ATK-së nr.80/2019 datë 29.03.2019 ka mbështetje dhe faktike si në shkresat e lëndës dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës bazuar në argumentet sikurse në vijim; pretendimi i paditësit lidhur me mosnjohjen e shpenzimeve të zhvlerësimit të aseteve kundërshtohen në tërësi për faktin se ATK ka vepruar në harmoni me vendimin shpjegues publik nr.05/2009 për Zhvlerësimin dhe dëmtimin e aseteve të ndërmarrjeve

me pronësi publike i cili është nxjerr sipas nenit 9 të Ligjit nr.03/L-222 për ATP. Në nenin 4 par.2 pika 2.2 të VSHP-së thuhet kuptimi i veçantë i "matjes në ngrohje" për asetet ekzistues në krijimin e AKM-së si kujdestare sqaron se ATK pranon se me krijimin e AKM-së si kujdestare për matjes në njohje të zërit të pronës, objektit dhe pajisjeve në koston e tij që është dashur të kualifikohet për njohje si aset është sqaruar në pikën 2.1 të këtij neni, nuk ka qenë e mundur për arsyet e shpjeguara në preambul (në veçanti rrethanat e pas luftës). Andaj, ATK e ka konsideruar matjen në momentin kur AKM është bërë kujdestare si matje e cila ka të njëjtin efekt si matje për njohje dhe shërben si shumë fillestare e zhvlerësuese për tatim për asetet që ekzistojnë në atë moment. Ndëshkimet janë aplikuar në harmoni me nenin 53 par.2 pika 4 i Ligjit Nr. 03/L-222 për ATP si dhe nenin 43 par. 98 pika 4 të U.A. 15/2010 për zbatim të LTP-së, ku parashihet se gjatë ecurisë së një kontrolli që mbulon vite të shumta, ndëshkimi për mos krijim apo mos mbajtje të librave, regjistrimeve të duhura sikurse kërkohet me neni 13 të Ligjit nr. 03/L-222 për ATP, aplikohen ndëshkimet për secilin vit. Mbështetur në dispozitat të sipërcituara, vërtetimin e gjendjes faktike si dhe interpretimin e drejtë të dëshmimeve tjera si në shkresat e lëndës, ATK-ja i propozon Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal që pas administrimit të provave dhe analizimit të dispozitave relevante, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar duke vërtetuar vendimin e Departamentit të Ankesave nr.80/2019 datë 29.03.2019.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se e paditura me parashtrësën e datës 15.10.2021 ka njoftuar gjykatën se nuk do të marr pjesë në seancën gjyqësore dhe propozon që të veprohet konform nenit 38.5 të LKA-së (provë: parashtrësja e datës 15.10.2021 nga ATK-ja).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit publik të datës 09.11.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 15.03.2021 nga ATK-së, vendimi nr.80/2019, i dt.29.03.2019 nga ATK-Departamenti i Ankesave në Prishtinë, ankesa për raportin e kontrollës nga ATK-ja e datës 25.02.2019, vendimi me nr.prot. 0179/2019 i datës 12.02.2019 I ATK-së, njoftim vlerësimi i datës 12.02.2019, Raporti i Kontrollit i datës 11.02.2019 nga ATK-ja, raporti i auditorit të pavarur, pasqyra për efektet negative financiare për shkak të zvoglimit drastic të shpenzimeve të zhvlerësimit sipas kontrollit financiar të datës 19.04.2019, draft raporti i auditimit, raporti i kontrollit 2012, lista e vlerësimit sipas evidencës kontabël, vendimi shpjegues publik.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në ankesë-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura thekson se kontrolli ka vlerësimi i kontrollit është bërë në mbështetje të nenit 14,15 dhe 19 të Ligjit 03/L-222 per Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe vlerësimi është bërë në harmoni me VSHP nr. 05/2009 për Zhvlerësimin dhe Dëmtimin e aseteve të ndërmarrjeve me pronësi publike (NPP) të nxjerr sipas nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. ATK për këto asete ekzistuese pranon shfrytëzimin e modelit të vlerësimit të bërë nga vlerësuesit e pavarur të kualifikuar në momentin kur AKM është bërë kompetente për NPP ose të bërë nga vetë (NPP) nëse e ka pasur aprovimin e organeve kompetente. Kontrolli nuk ka pranuar shpenzimet e zhvlerësimit nga rivlerësimi si shpenzim i zbritshëm në harmoni me VSHP nr. 05/2009 bazuar në të dhënat e koston së mëhershme sipas evidencës kontabël që ka paraqitur tatimpaguesi deri më 31.12.2007. Sa i përket ndëshkimeve

e paditura me të drejtë ka aplikuar nenin 53 paragrafin 2 të Ligjit nr. ndëshkimet janë aplikuar konform nenit 53 par.2.4 të Ligjit 03/L-222, dhe nenit 43 par.98.3 të UA 15/2010.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata pasi ka shqyrtuar provat e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet shtesë të kontrollit, me të cilat paditësi është ngarkuar me detyrime tatimore shtesë.

Gjykata pranon konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues se njohja e shpenzimeve të zhvlerësimit të asetëve të ndërmarjeve me pronësi publike është përcaktuar me Vendimin Shpjegues Publik nr.05/2009 për Zhvlerësimin dhe Dëmtimin e Asetëve të Ndërmarjeve me Pronësi Publike. Gjykata e konsideron të drejt këtë vlerësim të kontrollit tatimor, pasi e paditura ka autorizime ligjore nga neni 9 i Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të lëshoj vendim shpjegues të caktuar për qëllime tatimore:

Drejtori i Përgjithshëm mund t'i lëshojë një vendim shpjegues një personi të caktuar duke i sqaruar se si ATK do të interpretojë dhe zbatojë dispozitat e këtij legjislacionit tatimor që e administron atë ashtu siç zbatohet për një transaksionin të caktuar apo marrëveshje të planifikuar nga personi i cili kërkon vendimin shpjegues

Gjykata nga dispozita e nenit 4 paragrafi 2.2 të këtij Vendimi shpjegues publik, ka konstatuar se matjen në njohje për asetet ekzistuese, është momenti kur AKM-ja është bërë kujdestare e ndërmarrjeve publike sikurse dhe në rastin konkret me paditësen, dhe nga kjo njohje e momentit, matja në njohje shërben si shumë fillestare e zhvlerësimeve për tatim për asetet që ekzistojnë në atë moment.

Nga Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll, gjykata konstaton se kontrolli tatimor me të drejt ka trajtuar shpenzimet e zhvlerësimit sipas evidencës kontabël të deklaruara nga paditësja, duke mos i pranuar shpenzimet e zhvlerësimit nga rivlerësimi si shpenzim i zbritshëm në vështrim të Vendimit shpjegues publik nr.05/2009. Gjykata në këtë rast konstaton se pala paditëse nuk ka dokumentuar me fatura shpenzimet e zhvlerësimit në periudhën tatimore, prandaj gjykata e konsideron si të drejt veprimin e të paditurës e cila ka konfirmuar vlerësimin e kontrollit tatimor në vështrim të nenit 14,15 dhe 19 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku me të drejtë është konstatuar se paditësja nuk ka të drejt në shpenzimet e zhvlerësimit të asetëve. Në këtë kuptim gjykata i konsideron të drejta edhe ndëshkimet administrative të shqiptuara ndaj paditëses, të cilat vendime janë marrë konform dispozitës së nenit 53 paragrafi 2.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe dispozitës së nenit 43 paragrafi 98.3 të Udhëzimit Administrativ 15/2010.

Gjykata nuk ka mundur të pranoj pretendimet e paditëses se në vitin 2012 ka pas kontrollën e parë nga ATK-ja, për vitet 2004 dhe 2010, dhe inspektorët i pranojnë shpenzimet e zhvlerësimit në vlerësimin e asetëve. Gjykata konstatoi se vlerësimet e kontrollit sipas Raportit të Kontrollit datës 11.02.2019, janë të drejta dhe janë të referuara në legjislacionin tatimor në fuqi. Prandaj nga pretendimet e padisë gjykata konstatoi se ato nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër, meqë me provat e administruara e në vështrim të dispozitave të cekura ligjore, është vërtetuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditëses, andaj theksimet e padisë nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit administrativ.

Në rastin konkret gjykata konsideron se organi i paditur ka vërtetuar drejt faktet esenciale dhe ka nxjerr konkluzion të drejt në pikpamje të gjendjes faktike, duke aplikuar drejt edhe dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata konstaton se vendimi i Departamentit të Ankesave i ATK-së nr.80/2019 datës 29.03.2019, me të cilin është refuzuar ankesa e paditëses lidhur me Njoftim Rivlerësimet shtesë të caktuara me kontroll, është plotësisht i drejt dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të ATK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal,
A.nr.1026/19 datë 09.11.2021

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.